



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Zbatimi i ligjit për skemat pensionale të financuar nga shteti

Trajnuesit:

Delushe Halimi, Gjyqtare e Gjykatës së Apelit të Kosovës

Ramush Bardiqi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë

Prishtinë, data: 06.09.2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja e këtij moduli është e AD-së, ndërsa pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Akademisë së Drejtësisë.

Ky material nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	4
Objektivat mësimore.....	4
Metodat e të mësuarit.....	4
Pritjet nga pjesëmarrësit.....	4
Burimet dhe literatura.....	5
1. Të drejten në pension sipas ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti.....	6
2. Kriteret për njohjen e të drejtës në pension.....	8
3. Procedurat administrative të domosdoshme për njohjen e të drejtës në pension për pagesat e pensioneve.....	14
4. Procedimi dhe kalkulimi i pagesave	20

Hyrje

Ligjit për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti përcakton pensionet bazike të moshës, pensionet kontribut pagues të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalide të punës, si pensione të Shtyllës së I-rë , ne rast kur kontribusit lëndohen ne pune apo fitojn sëmundje profesionale. Ky ligj përcakton procedurat administrative permes te cilave personat mund te aplikojn per përfitime e pnsioneve. Me kete ligj unifikohet sigurimi i vazhduhem i këtyre pensioneve per shtetas te Kosoves dhe per shtetas te huaj. Qellimi i këtij trajnimi eshte avancimi i njohurive te gjyqatarve lidhur me zbatimin e unifikuar te legjislacionit ne fuqi per pensione

Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij prezantimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zberthej skemat pensionale te financuar nga shteti
- Zberthej procedurën administrative permes se cilave personat mund te aplikojn per përfitimin e pensioneve.
- Njohin kushtet e pranimit per pension
- Avncoj njohurit me skemat pensionale te përcaktuara me ligjit për skemat pensionale të financuar nga shteti.

Metodat e të shpjeguarit

Diklemat dhe çështjete e ngritura gjate trajnimit do te adresohen permes shpjegimit teorik , si dhe duke u bazuar ne raste dhe shembuj konkret. Gjithashtu permesushtrimeve, diskutimeve dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore te ligjit per skemat pensionale te financuara nga shteti, diskutime me pjesëmarrësit lidhur me rastet praktike në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi- Pjesa më e madhe e trajnimit do të realizohet me anë të punës me grupe punese që te japin konkluzionet për zgjedhjen e rasteve nga praktika gjyqesore.

Pritjet nga Pjesëmarrësit

Nga pjesëmarrësit pritet që të jenë aktiv dhe të përgatitur për diskutime edhe për çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këtë modul. Të njëjtit duhet të jenë bashkëpunues për aplikimin sa më të drejtë të ligjit për skemat pensionale të financuar nga shteti, dhe po ashtu mund të japin sugjerime ligjërish të bazuara, për mënyrën e zgjidhjes për rastet e caktuara.

Burimet e Shfrytëzuara dhe të konsultuara

- Ligjit për skemat pensionale të financuar nga shteti, NR. 04/L-131
- Udhëzim Administrativ (mpms) nr.07/2015 për procedurat e aplikimit dhe ankimit në skema pensionale të financuara nga shteti.
- Udhëzim administrativ (mpms) nr.06 /2015 për procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë së përherëshme.
- Udhëzim administrativ (mpms) nr. 09/ 2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve.
- udhëzim administrativ (mpms) nr. 02 12017 për procedurat administrative për njohjen e të drejtës për pension invalidor të punës.

TË DREJTEN NË PENSION SIPAS LIGJIT PËR SKEMAT PENSIONALE TË FINANCUARA NGA SHTETI

Ky ligj rregullon dhe përcakton pensionet bazike të moshës, pensionet kontribut pagues të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalide të punës, si pensione të Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti.

Paragrafi 4 i nenit 9 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përcakton se kërkesat për pension të paaftësisë së përhershme shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisionet Mjekësore, në Qendrat Rajonale të Administratës Pensionale. Po ashtu Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimit për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme, ka përcaktuar rregullimin e procedurave administrative, për realizimin e njohjes së të drejtës në pension të paaftësisë së përhershme, i cili në në paragrafin 3 të nenit 8 përcakton se: “Komisioni Mjekësor, në bazë të dëshmimeve mjekësore si dhe ekzaminimit të parashtruesit të kërkesës, vlerëson se ekziston apo nuk ekziston paaftësia e përhershme tek parashtruesi i kërkesës”.

Ndërsa në bazë të paragrafit 4 të këtij neni, organi i shkallës së parë është kompetent për marrjen e vendimit, pas vlerësimit të Komisionit Mjekësor, ndërsa konform dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, organi administrativ, në vendim duhet të jap sqarime të qarta lidhur me arsyetimin e aprovimit apo refuzimit të saj. Skema e pensioneve për pensionistët kontributpagues, kategorizimi i të cilëve rregullohet me ligj dhe me Udhëzimin Administrativ Nr.09/2015, jo rrallë herë përbën raste shqyrtimi me procedurën e konfliktit administrativ. Paragrafi 5 i udhëzimit të lartcekur, ka përcaktuar kushtet dhe dokumentet relevante që nevojiten për kualifikim të pensionistëve si shfrytëzues të pensionit kontributpagues, ndërsa paragrafi 5 i këtij neni përcakton se të gjitha dëshmitë për kualifikim, siç janë certifikatat, diplomat dhe dëshmitë tjera për përgatitjen shkollorë-universitare, duhet të jenë para vitit 01.01.1991. Aplikimi i kësaj dispozite në praktikë, shfaq komplikim në zgjidhjen e çështjeve të caktuara në mënyrë të drejtë, pasi që gjendja faktike paraqitet ndryshe. Ky ligj rregullon dhe përcakton:

- 1.Pensionet bazike të moshës,
- 2.Pensionet kontribut paguese të moshës,
- 3.Pensionet e aftësisë së kufizuar,
- 4.Pensionet e parakohshme,
5. Pensionet familjare
6. Pensionet invalide të punës, si pensione të Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti

Ky ligj parasheh Konsolidimin, harmonizimin dhe unifikimin e skemave pensionale të aplikueshme, të cilat aktualisht financohen nga Buxheti Shtetëror i Kosovës; krijimin e një kornize ligjore të unifikuar për sigurimin e vazhdueshëm të këtyre pensioneve për shtetasit e Republikës së Kosovës si dhe për shtetasit e huaj, në përputhje me marrëveshjet bilaterale të sigurimeve sociale, të cilat i nënshkruan Republika e Kosovës me shtetet përkatëse; kriteret dhe procedurat administrative të domosdoshme për njohjen e të drejtës në pension për pagesat e pensioneve. Ky

ligj përfshin Skemën e Pensionit Bazik të Moshës, Skemën e Pensionit Kontributpagues të Moshës, Skemën e Pensionit të Aftësisë së Kufizuar dhe Skemën e Pensionit të Parakohshëm, si dhe rregullon çështjet e pensionit familjar dhe invalidor të punës, në rastet kur kontribuesit lëndohen në punë apo fitojnë sëmundje profesionale. Krijon metodologji sipas së cilës vlera e pensioneve harmonizohet dhe përshtatet me rritjet e kostos së jetesës. Përcakton procedurat administrative përmes të cilave personat mund të aplikojnë për përfitimin e pensioneve. Adreson trajtimin e çështjeve të pagesave të tepërta dhe pensioneve të papaguara. Krijon një proces, sipas së cilit personat mund të rishikojnë kushtet e pranimit për pension. Krijon një rregull tranzicioni që iu takon personave që marrin pagesat e pensioneve në skemat dhe programet pensionale ekzistuese që janë duke u zbatuar; si dhe, Rregullon çështje të tjera nga skemat pensionale të përcaktuara më këtë akt ligjor, të cilat janë në interes dhe favor të shfrytëzuesve pensional.

Neni 3 të këtij ligji parashihen përkufizimet për shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: Pension - pagesë e rregullt mujore e paguar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për personin që i plotëson kushtet e pensionimit të parapara me këtë ligj; Pensionist - qytetari i Republikës së Kosovës, i cili i plotëson kushtet për të qenë përfitues i njërit nga skemat pensionale në Kosovë; Moshë e pensionimit – moshë e pensionimit, në përputhshmëri me këtë ligj, sipas kategorive të përfituesve nga skemat e pensioneve.

1. E drejta në Pensionet bazike të moshës- Pensioni bazik i moshës - pensioni minimal i rregullt mujor të paguar për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, që kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare, pa marrë parasysh, a kanë qenë të punësuar apo jo dhe të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj;

2.E drejta në Pension kontributpagues i moshës - pensioni i rregullt mujor për qytetarët e punësuar në Republikën e Kosovës, të cilët i kanë paguar kontributet, në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 01.01.1999 sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 26/83) e të cilët i plotësojnë kriteret e paraparë me këtë ligj;

3.E drejta në Pensioni i pa aftësisë të përhershme - pensioni i rregullt mujor i paguar për qytetarët e Republikës së Kosovës, bazuar në vendimin e organit përkatës të Ministrisë, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj;

4. E drejta në Pensioni i parakohshëm - pensioni i rregullt mujor i paguar për minatorët e kompleksit “Trepça”, dhe minatorëve të tjerë të punësuar në minierat e tjera të Kosovës, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj.

5. E drejta në Pensioni familjar - pensioni i rregullt mujor i paguar për anëtarët e familjes në rast të vdekjes së të punësuarit, që ka qenë në marrëdhënie pune, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj.

6. E drejta në Pensioni invalidor i punës - si pensione të Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti pensioni i rregullt mujor, i paguar për personat që pësojnë lëndime në punë apo fitojnë sëmundje profesionale gjatë marrëdhënies së punës, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj, si dhe invalidët e punës sipas Ligjit Pensional dhe Invalidor të aplikuar para datës 01.01.1999. Komisioni Mjekësor - organi i ekspertizës mjekësore, i emëruar nga Ministria për të përcaktuar gjendjen shëndetësore, përkatësisht të aftësisë së kufizuar; Anëtarët e familjes - janë bashkëshorti/ja, fëmijët martesor, jashtëmartesor dhe të birësuar; KRRJ – Kostoja e Rregullimit të Jetesës - kostoja e rregullimit të jetesës si metodë e përlllogaritjes së kostos së shpenzimeve ditore; Ministria” - ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS).

Sigurimi i mjeteve financiare për pagesat e pensioneve mjetet financiare për pagesën e të gjitha pensioneve të përcaktuara me këtë ligj, do të sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës garanton realizimin e të drejtave për të gjitha llojet e pensioneve të përcaktuara me këtë ligj.

I. KRITERET PËR NJOHJEN E TË DREJTËS NË PENSION

Pensionin bazik i moshës do t’iu paguhet të gjithë personave që janë shtetas të përhershëm të Republikës së Kosovës, të cilët posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare. 2. Dokumente valide të domosdoshme për njohjen e të drejtës në pension bazik të moshës janë: 2.1. Letërnjoftimi, i lëshuar nga organi përgjegjës i Republikës së Kosovës; 2.2. Vërtetimi nga Zyra Civile se është banor i përhershëm në adresën e caktuar. 3. Përveç dokumenteve valide të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, aplikuesi me rastin e paraqitjes së kërkesës për pension bazik të moshës, duhet të paraqes edhe këto dokumente: 3.1. Fletën e aplikacionin për pension. Llogarinë bankare, të lëshuar në njërin nga bankat që operojnë në Kosovë.

Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: 1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999, ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999. Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributdhënës, sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit sipas strukturës kualifikuese dhe kriterëve tjerë, përcaktohet me akt nënligjor, të cilin do ta miratoj ministria përkatëse.

Personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontributpagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj. Përfundimisht, shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues të moshës, dhe shfrytëzuesit e pensioneve tjera të përcaktuara me këtë ligj, mund të jenë edhe shtetasit e huaj, me shtetin e të cilëve, Republika e Kosovës, lidh Marrëveshje Bilaterale për sigurimet sociale. Dispozitat e Marrëveshjeve Bilaterale të sigurimeve sociale, të cilat i lidh Republika e Kosovës me shtetet përkatëse, kanë epërsi ndaj

dispozitive të këtij ligji dhe ligjeve tjera nga fusha e sigurimeve sociale. Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës.¹

Sipas Udhëzimit Administrativ (mpms) nr. 09/ 2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve ka për qëllim të përcaktojë kushtet dhe kriteret për kategorizimin pensionistëve kontributpagues, duke u bazuar në strukturën kualifikuese dhe kohëzgjatjen e pagesave të kontributeve pensionale. Ky Udhëzim, iu dedikohet të gjithë pensionistëve aktual dhe atyre të cilët aplikojnë për herë të parë në pension kontributpagues të përcaktuar me Ligjin në fuqi për Skemat Pensionale të Financuara nga Neni 4 Kategorizimi sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesave të kontributeve.

Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese, ndahet në katër(4) kategori:

- 1.Pensionistët me përgatitje shkollore të ultë;
- 2.Pensionistët me përgatitje shkollore të mesme;
- 3.Pensionistët me përgatitje shkollore të lartë
4. Pensionistët me përgatitje shkollore superiore .

Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas kohëzgjatjes së stazhit dhe pagesave të kontributeve, llogaritet sipas vlerës 0.5% për çdo vit, të shumës aktuale të pensionit kontributpagues. Lartësia e shumës së pensioneve sipas paragrafit 1 të këtij neni, caktohet me vendim të Qeverisë pas konsultimit me Ministrinë e Financave. Baza e pensionit kontributpagues është shuma e përcaktuar sipas vendimit të fundit të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës nr.01/74 i datës 10.03.2014. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të ultë, konsiderohet i siguruari ose pensionisti kontributpagues, pa ose me përgatitje shkollore të ultë Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të mesme, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer shkollën e mesme.Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të lartë, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili e ka të kryer shkollimin e lartë. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore superiore, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer fakultetin apo studimet pasuniversitare.

Të gjitha dëshmitë për kualifikim, të përcaktuara nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, duhet të jenë para vitit 01.01.1991. Dokumentet e nevojshme për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues. Të gjithë shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues, përkatësisht të siguarit me rastin e parashtrimit të kërkesës për pension kontributpagues, bazuar në kategorizimin sipas dhe 5 të këtij Udhëzimi, varësisht se për cilën kategori aplikojnë. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në dispozitat e Ligjit në fuqi për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, shfrytëzuesit aktual dhe ata që aplikojnë në të ardhmen, duhet të paraqesin dokumentet e

¹ Ligjit për skemat pensionale të financuar nga shteti, NR. 04/L-131

nevojshme, si:-Letërnjoftimin e Republikës së Kosovës, -Ekstraktin e lindjes-Të kenë stazh pensional kontributdhënës së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet para datës 01.01.1999, sipas Ligjit të SPI-së të Kosovës, nr. 26/83, i cili vërtetohet me ndonjë nga këto dokumente, si: vendimin se ka qenë shfrytëzues i pensionit kontributpagues sipas dispozitave të Ligjit të SPI-së Nr. 26/83, para datës , 01.01.1999 çekun për pagesën e pensionit kontributiv sipas dispozitave nga Ligji i SPI-së të Kosovës, librezën e punës me numrin amëz të të siguarit, dëshminë se i ka paguar punuar, ekstraktin nga M-4, nëse i posedojnë zyrat pensionale, të cilat nxirren,verifikohen dhe plotësohen nga zyrtari për verifikim i stazhit pensional në formularin përkatës, dëshmi se nuk është përfutues i pensionit nga ndonjë prej shteteve për të cilat Kosova nuk ka marrëveshje, dëshmi për njohjen e stazhit të punës për të punësuarit e arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës nga vitit 1989-1999 e verifikuar nga Qeveria, përkatësisht ministrite relevante, Të ofrojë dëshmi së në Bazën e të Dhënave të ish Teknologjisë Informative, e ashtuquajtura Qendra Elektronike Llogaritare e ish BV1-SP1-së të Kosovës Regjionale, të cilat nxirren e verifikohen dhe plotësohen nga zyrtari për verifikim i stazhit pensional në formularin përkatës në zyrat pensionale përkatëse. Në rast se në Formularin M-4 mungon periudha kontributpaguese deri në dymbëdhjetë (12) muaj përkatësisht një (1) vit².

Të drejtës në pension të pa aftësisë së përhershme- Pensioni i paaftësisë të përhershme do t'iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Pensioni i paaftësisë së përhershme do t'iu paguhet të gjithë atyre personave që janë shtetas të Republikës së Kosovës, që posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët i kanë tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç.

Te drejten në pension të parakohshëm-Neni 5 i UA parasheh peroceduren per realizimin e drejta në pension të parakohshëm. Të drejtën në pension të parakohshëm e realizojnë të gjithë të punësuarit në Kompleksin "Trepça" dhe në minierat e tjera të Kosovës, të cilët kanë humbur vendin e punës deri në fund të vitit 2004, shtetas të Kosovës të moshës prej pesëdhjetë (50) deri

gjashtëdhjetë e pesë (65) vjet.-Dokumentet që duhen parashtruar, janë:Letërnjoftimi i lëshuar nga organi përgjegjës i Republikës së Kosovës, Dëshmi për së paku dhjetë (10) vjet stazh pune në minierat e Kompleksit "Trepça" dhe minierave të tjera, Dëshmi se nuk janë në marrëdhënie pune apo të vetëpunësuar, Dëshmi se iu është ndërprerë marrëdhënia e punës, pa fajin e tij/saj, Dëshmi se janë të paaftë për punë përmbi 50%, për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, Ekstrakt nga Zyra Civile se është banor i përhershëm në adresën e caktuar, Ekstraktin e lindjes, Një nga dëshmitë për faturat të të cilatjanë në emër të tij: faturën e tatimit në pronë, energjisë elektrike, ujit apo mbeturinave, Dëshmi të tjera eventuale, të kërkuara nga zyrtari përgjegjës i zyrës pensionale

² Udhëzim administrativ (mpms) nr. 09/ 2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve

përkatëse. Pensionet e parakohshme do të ndërpriten së paguari, nëse personi: mbush moshën e pensionimit për realizimin e pensionit bazik të moshës; punësohet apo vetëpunësohet; ka përmirësime të gjendjes shëndetësore mbi pesëdhjetë përqind (50 %) ose vdes.

E drejta në pension familjar- të drejtën në pension familjar e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit familjar nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare, të cilët realizimin e kësaj të drejte e dëshmojnë me vendim apo fletëpagesë të pensionit, që tregon se kanë qenë shfrytëzues të pensionit familjar, para datës 01.01.1999, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 26/83. Anëtarët e ngushtë të familjes të ish të siguruarit që kanë vdekur pas datës 01.01.1999, të cilët dëshmojnë se i siguruari ka paguar për pesëmbëdhjetë (15) vjet kontributet për stazhin pensional sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 para datës 01.01.1999.

Anëtarët e familjes së të punësuarit/ës që kanë vdekur pas vitit 01.01.1999, si pasojë e lëndimit në punë apo sëmundjes profesionale, pa marrë parasysh kohëzgjatjen e stazhit të punës, Dokumentet që duhet të parashtrohen, janë, Letërnjoftimi i lëshuar nga organi përgjegjës i Republikës së Kosovës, Vendimin mbi njohjen e të drejtës në pension apo çekun për pagesën e pensionit të ish sigurimit pensional, çertifikatën e kurorëzimit për bashkëshortin/en nën moshën gjashtëdhjetë e pesë vjeçare, Vërtetim që nuk janë në marrëdhënie pune apo të vetëpunësuar, Vërtetim që bashkëshorti/ja është shpallur invalid i përhershëm dhe i paaftë për punë, nën moshën 45 vjeç;

-Vërtetimi i fëmijëve mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare deri në njëzet e gjashtë (26) vjeçare për vijimin e shkollimit të rregullt;

-Dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 01124/83 para datës 01.01.1999;

- Fletëparaqitjen mbi lëndimin në punë apo ekstraktin mbi sëmundjen profesionale;

- Ekstrakt nga Zyra Civile se është banor i përhershëm në adresën e caktuar

- Ekstraktin e lindjes

-Një nga dëshmitë për faturat të të cilat janë në emër të tij: faturën e tatimit në pronë, energjisë elektrike, ujit apo mbeturinave.,-Dëshmi të tjera eventuale, të kërkuara nga zyrtari përgjegjës i zyrës pensionale përkatëse.

Të drejtën në pension familjar e realizojnë, anëtarët e ngushtë të familjes, të ish të siguruarit që ka vdekur pas datës 01.01.1999, të cilët dëshmojnë se i siguruari ka paguar për pesëmbëdhjetë (15) vite kontributet për stazhin pensional. Të drejtën në pension familjar e realizojnë anëtarët e familjes të të punësuarit/ës, që kanë vdekur pas vitit 01.01.1999, si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale, pa marrë parasysh kohëzgjatjen e stazhit të punës. Të drejtën në pension familjar, sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, e realizojnë: bashkëshorti/ja, deri në moshën gjashtëdhjetë e

pesë (65) vjeç, që dëshmojnë se janë në kurorë si dhe nuk janë në marrëdhënie pune ose të vetëpunësuar;

Bashkëshorti/ja, nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare, i shpallur invalid i përhershëm dhe i pa aftë për punë; fëmijët deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare përkatësisht njëzet e gjashtë (26) vjeçare, nëse ofrojnë dëshmi përkatëse për vijimin e shkollimit të rregullt universitar. Lartësia e pensionit familjar, sipas paragrafit 1, 2 dhe 3 të këtij neni është e njëjtë me lartësinë e pensionit bazik të moshës. Në rastet, kur pas vdekjes së personave sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni apo pensionistit invalidor të punës, përveç bashkëshortit/ës, shfrytëzues të pensionit familjar janë edhe fëmijët, atëherë shuma e pensionit familjar për secilin fëmijë rritet për njëzet përqind (20%) të pensionit bazik të moshës. Nëse fëmijët janë pa asnjë prindër dhe i plotësojnë kushtet dhe kriteret për shfrytëzimin e pensionit familjar, baza e pensionit familjar, është në lartësinë e pensionit bazik të moshës, dhe duke përfshi rritjen prej njëzet përqind (20%) . Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në Pension Familjar. Të drejtën për pension familjar e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit familjar të cilët janë nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare dhe të cilët realizimin e kësaj të drejte e dëshmojnë me Vendim apo fletëpagesë të pensionit që tregon se kanë qenë shfrytëzues të pensionit familjar, para datës 01.01.1999, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor.

Pension invalidor të punës-Të drejtën në pension invalidor të punës e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit invalidor, nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare të cilët e dëshmojnë realizimin e kësaj të drejte me Vendim apo (fletëpagesë) të pensionit që tregon se kanë qenë shfrytëzues të pensionit invalidor të punës, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 26/83), para datës 01.01.1999. E drejta në pension invalidor të punës iu njihet edhe të gjithë të punësuarve aktual, tek të cilët është shfaqur paaftësia e plotë për punë, si pasojë e lëndimit në punë apo e sëmundjes profesionale. Lartësia e pensionit invalidor të punës është në shumë të njëjtë me pensionin bazik të moshës. Verifikimin dhe vlerësimin e lëndimit në punë dhe sëmundjeve profesionale do ta bëjnë institucionet publike të specializuara të Mjekësisë së Punës në Republikën e Kosovës.³

Çdo person i punësuar, i cili lëndohet në punë apo fiton sëmundje profesionale, sipas nenit 4 paragrafin 2 të këtij Udhëzimi, para se të parashtrijë kërkesë për pension invalidor të punës, është i detyruar që të kryejë verifikimin dhe vlerësimin e lëndimit në punë dhe sëmundjeve profesionale. Verifikimin dhe vlerësimin e lëndimit në punë dhe sëmundjeve profesionale e bëjnë institucionet publike të specializuara të Mjekësisë së Punës në Republikën e Kosovës. Varësisht nga shkalla dhe kategoria e lëndimeve, përkatësisht sëmundjeve profesionale, përcaktohet diagnoza në formë të ekspertizës nga institucioni i Mjekësisë së Punës.⁴

³ Ligji për pensione te financuara nga sheti nr.04/L-131

⁴ Udhëzim administrativ (mpms) nr. 02 12017 për procedurat administrative për njohjen e të drejtës për pension invalidor të punës.

Neni 13 Lartësia e shumës së pensioneve -Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave, me vendim të veçantë, do të vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve të përcaktuara me këtë ligj. Harmonizimi i pensioneve me koston e jetesës, Harmonizimi i pensioneve me koston e jetesës do të bëhet një herë në vit duke rritur shumën e pensionit që duhet paguar me të njëjtën përqindje bazuar në Indeksin e Kostos së jetesës të vitit paraprak. 2. Pasi të jetë aplikuar rritja me përqindjen rezultuese, shuma e pensionit që del do të rrumbullakësohet me numrin më të afërt të plotë (të shprehur në Euro). 3. Indeksi i Kostos së jetesës do të përcaktohet nga Ministria e Financave dhe do të reflektojë ndryshimet në mesataren e shpenzimeve të jetesës të pensionistëve.

Ministria e Financave, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 2002/1 mbi metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit bazë në Kosovë, do të jetë përgjegjëse për llogaritjet që kërkohen nga ky ligj dhe për përcaktimin e nivelit të rritjes së pagesave të pensioneve të përcaktuara me këtë ligj. 5. Në rast se ndonjë pension i paguar në bazë të këtij ligji, rritet me akt tjetër ligjor apo nënligjor, apo me ndonjë masë tjetër të autorizuar administrative, atëherë nuk do të zbatohet KRRJ për dy (2) vite kalendarike, duke filluar nga muaji kur rritja ka hyrë në fuqi.

Beneficionet Subjekt i Vështirësive Fiskale Në rast të jostabilitetit financiar dhe me qëllim të ruajtjes së disiplinës fiskale publike, zbatohet neni 36 i Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe neni 4 i Ligjit nr.04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 16 parasheh kufizimet në numrin e pensioneve të paguara. Personat të cilët janë përfitues të të cilit do pension të Skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj, nën asnjë rrethanë, nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni nga skemat e veçanta pensionale të cilat menaxhohen dhe administrohen nga Ministria.

Ministria, do të rishikojë moshën e pensionimit, jo më pak se çdo pesë (5) vjet, duke u bazuar në të dhënat zyrtare dhe do ta përshtatë atë sipas rritjes së jetëgjatësisë. 2. Moshë e pensionimit mund të përshtatet me shtesa prej gjysmë viti. Departamentit përkatës për pensione 1. Departamenti përkatës për pensione i Ministrisë, është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj. 2. Departamenti veçmas është përgjegjës për: 2.1. propozimin dhe përgatitjen e politikave dhe strategjive lidhur me sistemin pensional në Republikën e Kosovës; 2.2. menaxhimin dhe administrimin e procedurave të aplikimit dhe ankimit përmes, të cilave iu mundësohet personave që të aplikojnë për pensionet të parapara me këtë ligj; 2.3. hartimin e akteve nënligjore që rregullojnë dhe përcaktojnë kriteret për njohjen e të drejtave në skemat pensionale të përcaktuara me këtë ligj; 2.4 administrimin e një procesi, sipas të cilit përcaktohen të drejtat sipas ankimit, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni; 2.5. menaxhimin me kohë të pagesave të pensioneve të pensionistëve të përcaktuara me dokumentet kontraktuale në mes të Ministrisë dhe ndonjërit nga bankat e vendit; 2.6. mbajtjen e evidencës së faturave dhe mjeteve financiare për pagesën e pensioneve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike; 2.7.

përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit për të gjitha shpenzimet lidhur me shpërndarjen e pensioneve; 2.8. monitorimin e statusit të personave që marrin pensione; 2.9. çështje tjera, të cilat janë të përcaktuara me akte tjera nënligjore.

III . PROCEDURAT ADMINISTRATIVE TË DOMOSDOSHME PËR NJOHJEN E TË DREJTËS NË PENSION PËR PAGESAT E PENSIONEVE.

3.1 Procedura e aplikimit /Paraqitja e kërkesës dhe ankesës

Neni 7 i UA nr.07/2015 për procedurat e aplikimit dhe ankimit në skema pensionale të financuara nga shteti parasheh peroceduren e aplikimit-perkatesisht te paraqitjes se kekeses.

1.E drejta për të aplikuar në pension bazik të moshës, pension të parakohshëm dhe pension familjar, ushtrohet përmes kërkesës së palës, përkatësisht formularit për aplikim në pension, e cila duhet të përmbajë emërtimin e organit të cilit i drejtohet, emrin e kërkuesit, arsyen për njohjen e të drejtës në pension datën e dorëzimit dhe nënshkrimin e palës. Kërkesa, së bashku me dokumentacion përkatës, paraqitet në zyrën pensionale përkatëse sipas vendbanimit rënë të afërt të palës. Në rast se pala, për shkak të pamundësisë nuk mund të paraqesë kërkesë, mund t'a autorizojë personin tjetër që në emër të tij/saj t'a parashtojë kërkesën. Autorizimi duhet të jetë i noterizuar. Zyra e pensioneve, përkatësisht zyrtari përgjegjës i pranimit, sigurohet se kërkesa e paraqitur nga pala ose i/e autorizuari i tij/saj, është e kompletuar me dëshmitë relevante.

Në qoftë se zyrtari përgjegjës konstaton se parashtruesi i kërkesës, nuk e ka plotësuar kërkesën siç parashihet në ligjin në fuqi dhe dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ, zyrtari përgjegjës nxjerr konkluzion mbi plotësimin e lëndës, përkatësisht sigurimin e provave apo dëshmime, kërkon nga parashtruesi që në afat prej 15 ditësh t'i sjellë dëshmitë e kërkuara me qëllim që kërkesa e tij të përcillet në procedurat e mëtutjeshme për vendimmarrje. Nëse parashtruesi i kërkesës, edhe pas 15 ditësh nuk sjell dëshmitë apo provat e kërkuara, atëherë, kërkesa e tij për njohjen e së drejtës në pension, i refuzohet përmes konkluzionit. Ndaj refuzimit të kërkesës për aplikim, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë në ankesë në shkallën e dytë të Ministrisë.

Neni 8 i UA parasheh pranimi i kërkesës Në qoftë se zyrtari përgjegjës i pranimit të zyrës pensionale përkatëse, e pranon dokumentacionin si të kompletuar, është i detyruar t'ia lëshojë parashtruesit të kërkesës, dëshminë për pranimin e kërkesës. Kërkesa regjistrohet në librin zyrtar - në protokoll. Në rast se kërkesa është për pension të parakohshëm, zyrtari përgjegjës e njofton aplikuesin për datën dhe vendin e kontrollimit/ekzaminimit mjekësor.

Neni 9 i UA parasheh shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës të gjitha kërkesat e pranuar për pension sipas dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ, shqyrtohen dhe vendosen në zyrën pensionale përkatëse të Departamentit të Pensioneve të Ministrisë. Në rast se kërkesa është paraqitur për pension të parakohshëm, kërkesat shqyrtohen nga Komisioni Mjekësor, i cili kontrollon mjekësore të parashtruesve të kërkesave, i kryen në zyrat pensionale përkatëse. Komisioni Mjekësor, pas

shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës, lëndën së bashku me dokumentet përcjellëse, i kthen tek organi i shkallës së parë, për marrjen e vendimit. Kërkesa duhet të shqyrtohet dhe vendoset në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e parashtrimit. Parashtruesi i kërkesës duhet të njoftohet me shkrim me vendimin e organit të shkallës së parë.

Parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me vendimin e shkallës së parë, ka të drejtë të ushtrojë ankesë në komisionin e shkallës së dytë të Ministrisë, përkatësisht në Divizionin për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Parashtrësive dhe Ankesave të Departamentit Ligjor. Ankesa bëhet në formë të shkruar në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Organi i shkallës së dytë, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, nxjerr vendim lidhur me ankesën. Nëse refuzohet ankesa, organi i shkallës së dytë udhëzon palën për mundësinë e zhvillimit të procedurave të më tutjeshme gjyqësore. Pala e pakënaqur me vendimin e organit të shkallës së dytë, me padi, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, mund të hapë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.⁵

2. Pensionit kontributpagues-Neni 10 i UA parasheh procedurën administrative për njohjen dhe realizimin e pensionit kontributpagues. Të gjithë shfrytëzuesve aktual të pensionit kontributpagues janë të kualifikuar dhe do t'ju vazhdohet pagesa e pensionit kontributiv. Të gjithë shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues janë të detyruar të parashtrorjnë kërkesë nëpër zyrat pensionale që pensioni kontributpagues të kategorizohet sipas strukturës së tyre kualifikuese dhe kohëzgjatjes së stazhit pensional. Zyrtari përgjegjës i zyrave pensionale, i pranon të gjitha aplikacionet e kompletuara me dëshmitë relevante/përkatëse për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues në pajtueshmëri me Ligjin në fuqi për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe të këtij Udhëzimit Administrativ. Zyra e pensioneve, përkatësisht zyrtari përgjegjës i pranimit, sigurohet që kërkesa. Përkatësisht formulari përkatës i plotësuar, e paraqitur ngaparashtruesi i kërkesës, është i kompletuar sipas dispozitave të Ligjit Nr. 04/1—131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe të këtij Udhëzimi Administrativ.

Në qoftëse zyrtari përgjegjës konstaton se parashtruesi i kërkesës, nuk e ka plotësuar kërkesën siç parashihet në Ligjin në fuqi për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ, zyrtari përgjegjës nxjerr konkluzion mbi plotësimin e lëndës, përkatësisht sigurimin e provave apo dëshmive, kërkon nga parashtruesi që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve t'i sjellë dëshmitë e kërkuara me qëllim që kërkesa e tij . të përcillet në procedurat e më tutjeshme për vendimarrje. Nëse parashtruesi i kërkesës, edhe pas pesëmbëdhjetë (15) ditëve nuk sjell dëshmi apo provat e kërkuara, atëherë, kërkesa e tij për njohjen e së drejtës në pension kontributpagues, përmes konkluzionit, i refuzohet kërkesa. Ndaj refuzimit të kërkesës për pension kontributpagues, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë në ankesë në shkallën e dytë të Ministrisë. Në qoftëse zyrtari përgjegjës i pranimit të zyrës pensionale përkatëse, pranon kërkesën si të kompletuar, është i detyruar t'ia lëshojë parashtruesit të kërkesës, dëshminë për pranimin e kërkesës. Kërkesa regjistrohet në librin zyrtar- në protokoll. Të gjitha kërkesat e pranuar për kategorizim të pensionit

⁵ Udhëzim administrativ (mpms) nr.07/2015 për procedurat e aplikimit dhe ankimit në skema pensionale të financuara nga shteti

kontributpagues nga zyrat e pensioneve përkatëse, shqyrtohen dhe vendosen në zyrat pensionale përkatëse të Departamentit të Pensioneve të Ministrisë, si organ i shkallës së parë të vendosjes. Parashtruesi i kërkesës, duhet të njoftohet me shkrim me vendimin e organit kompetent. Të gjitha kërkesat, shqyrtohen dhe vendosen në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës. E drejta e ankesës-Parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me vendimin e shkallës së parë, ka të drejtë të ushtrojë ankesë në komisionin e shkallës së dytë të Ministrisë, përkatësisht në Divizionin. për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Parashtrësive dhe ankesave të Departamentit Ligjor. Ankesa bëhet në formë të shkruar në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Organi i shkallës së dytë, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, nxjerr vendim për miratimin ose refuzimin e ankesës.

3. Kërkesa për pension të paaftësisë së përhershme, duhet të parashtrohet në organet përkatëse të Ministrisë, të cilat janë të instaluar në Komunitatet e Kosovës. Kërkesat për pension të paaftësisë së përhershme shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisionet Mjekësore, në Qendrat Rajonale të Administratës Pensionale. Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse: ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore; Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës; 5.3. Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh; Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nënparagrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor.

-Ministria apo Autoriteti përkatës mund t'i autorizojnë zyrtarët përgjegjës për inspektime të rastësishme apo sistematike të personave, të cilat marrin pensionin e paaftësisë së përhershme, me qëllim të verifikimit të fakteve të dhëna në kërkesë dhe vazhdimësisë së përzgjedhjes për shfrytëzimin e pensionit të aftësisë së kufizuar. Procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë të përhershme duhet të përmbajnë rregulla të përcaktuara me qëllim të mbrojtjes së informatave mjekësore konfidenciale të aplikuesve të cilat do të përcaktohen me akte nënligjore.

Kërkesa, së bashku me dokumentet tjera të përcaktuara në nenin 5 të këtij udhëzimi, dorëzohet në zyret e pensioneve përkatëse sipas vendbanimit më të afër të palës. Në rast se pala për shkak të pamundësisë nuk mund të paraqes kërkesën, mund ta autorizon personit tjetër që në emër të tij/saj ta parashtron kërkesën ose ta dërgoj përmes postës të regjistruar. Zyra e pensioneve, përkatësisht zyrtari përgjegjës i pranimit, sigurohet se kërkesa e paraqitur nga pala ose i/e autorizuari i tij/saj, ose përmes postës, është e kompletuar sipas nenit 5 të këtij udhëzimi. Në qoftëse zyrtari përgjegjës konstaton se parashtruesi i kërkesës, nuk e ka plotësuar dokumentacionin siç parashihet në nenin 5 të këtij Udhëzimi Administrativ, zyrtari përmesë konkluzionit mbi plotësimin e lëndës. përkatësisht sigurimin e provave apo dëshmimeve, kërkon nga parashtruesi që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve të sjelli dëshmitë e kërkuara me qëllim që kërkesa e tij të përcjelljet në procedurat e mëtutjeshme për vendim marrje. Nëse parashtruesi i kërkesës, edhe pas pesëmbëdhjetë (15) ditëve nuk sjell dëshmi apo provë, atëherë, kërkesa e tij për njohjen e së drejtës në pension të paaftësisë së përhershme, përmes konkluzionit i refuzohet kërkesa.

Ndaj refuzimit të kërkesës për aplikim të drejtën në pension të paaftësisë së përhershme, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë në ankesë në shkallën e dytë të Ministrisë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së konkluzionit. Zyrtari përgjegjës i pranimit në zyrën pensionale përkatëse, me rastin e pranimit të kërkesës të kompletuar, është i detyruar të ia lëshoj parashtruesit, dëshmin për pranimin e kërkesës. Kërkesa regjistrohet në librin zyrtar- në protokol. Zyrtari përgjegjës e njofton parashtruesin e kërkesës për zhvillimin e procedurës, përkatësisht të vlerësimit nga komisioni mjekësor. Kërkesat për pension të paaftësisë së përhershme shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni Mjekësorë i Departamentit të Pensioneve. Komisioni Mjekësorë, shqyrtimin e lëndës dhe ekzaminimet mjekësore, i kryen në zyret pensionale përkatëse.

Komisioni Mjekësorë, në bazë dëshmime mjekësore si dhe ekzaminimit të parashtruesit të kërkesës, vlerëson se ekziston apo nuk ekziston paaftësia e përhershme tek parashtruesi i kërkesës. Komisioni Mjekësorë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës, lëndën së bashku me dokumentet përcjellëse, e kthen tek organi i shkallës së parë për marrjen e vendimit në afat prej ajashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e Parashtrimit. Parashtruesi i kërkesës njoftohet me shkrim për vendosjen e kërkesës.

Të gjithë shfrytëzuesit e pensionit të paaftësisë së përhershme, i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit mjekësor pas skadimit të afatit të përcaktuar prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh. Zyrtari përgjegjës i zyrës pensionale përkatëse, pesëmbëdhjetë (15) ditë para skadimit të Vendimit e njohton shfrytëzuesin e pensionit, për datën dhe vendin e procedurës së rivlerësimit mjekësor. Riaplikimi për pensionin e paaftësisë së përhershme, mund të bëhet nga parashtruesi i kërkesës, vetëm pasi të kenë kaluar dy Vite (2) nga data e nxjerrjes së vendimit përfundimtar në procedurën administrative. Kërkesa për riaplikim dorëzohet në Zyrën pensionale përkatëse. Zyrtari i pensioneve, udhëzon parashtruesin e kërkesës, për procedurën e riaplikimit. Krahas kërkesës me shkrim, parashtruesi i kërkesës, me rastin e riaplikimit, duhet ti dorëzoj edhe këto dëshmi. Vendimin përfundimtar me të cilin i është refuzuar kërkesa, respektivisht vendimi i refuzuar sipas ankesës. Dëshmi të reja mjekësore në bazë të të cilavekonstatohet se gjendja shëndetësore krahasuar me gjendjen e mëprshme ka shenja të përkeqësimit të vazhdueshëm.

Në raste të veçanta aplikuesi për pensionin e paaftësisë së përhershme, mund të riaplikoj edhe pa u mbushur dy (2) vite, por jo më parë se gjashtë (6) muaj nga data e nxjerrjes së vendimit të fundit kur i është trajtuar kërkesa përkatësisht ankesa për pension të paaftësisë së përhershme. Riaplikimi pas gjashtë (6) muajsh për pensionin e paaftësisë së përhershme, mund të bëhet kur janë në pyetje sëmundjet me zhvillim të shpejtë të cilat dëmtojnë shumë shëndetin, në bazë të të cilit dëshmohet se janë plotësisht dhe përherë të paaftë për çfarëdo lloji të punës. Sëmundjet të cilat kanë një zhvillim të përshpejtuar dhe që dëmtojnë rëndë shëndetin si dhe zvogëlojnë në tërësi aftësitë e punës sipas vlerësimit të Komisionit Mjekësor të MPMS-së, janë: Karcinomat e të gjitha organeve të vërtetuara me ekzaminim histopatologjik, Insulti cerebrovaskular, Status post infarktus myocar, Insuficienca renale terminale, Hemopatitë, Politraumat (giatë aksidenteve, amputimet e extremiteteve), Epilepsia me kriza të shpeshta, Psikozat e renda, Ciroza hepatike e dekompensuar, Arthriti rheumatoid gr. III-IV, Morbus Perthes dhe Sëmundje të tjera që dëmtojnë

rëndë shëndetin. Parashtruesi i kërkesës i paknaqur me vendimin e shkallës së parë, ka të drejtë të ushtrojë ankesë në komisionin e shkallës së dytë të Ministrisë. Ankesa bëhet në formë të shkruar në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Organi i shkallës së dytë, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, nxjerr vendim për miratimin ose refuzimin e ankesës.⁶

E Drejta per pension invalidor te punës-sipas nenit 6 të UA nr. 02/2017 për procedurat administrative për njohjen e të drejtës për pension invalidor të punës parasheh procedurën e aplikimit për pensionin invalidor të punës. E drejta për të aplikuar në pension invalidor të punës, ushtrohet përmes kërkesës së palës, përkatësisht formularit për aplikim në pension, e cila duhet të përmbajë emërtimin e organit të cilit i drejtohet, emrin e kërkuesit, arsyen për njohjen e të drejtës në pension invalidor të punës, datën e dorëzimit dhe nënshkrimin. Kërkesës duhet të bashkëngjiten edhe këto dokumente, si në vijim: fletëlëndimin për lëndimin në punë, ekspertiza për sëmundjen profesionale, kopjen e dokumentit të identifikimit, kontratën e punës, pasqyrën e pagesës së kursimeve pensionale, raportin e Inspektoratit të punës për lëndimin në punë, vendimin apo fletëpagesën se ka qenë shfrytëzues i pensionit invalidor të punës, përkatësisht vërtetimin se pala ka qenë përfitues i pensionit invalidor para vitit 1999, vërtetim ky i lëshuar nga Departamenti i Pensioneve, Ekstraktin e lindjes, faturën e tatimit në pronë dhe njëzë nga këto dëshmi, si faturën e energjisë elektrike, faturën e ujit dhe faturën e mbeturinave. Në mungesë të dëshmive nga paragrafi 2.9. të këtij neni, parashtruesi i kërkesës, duhet të sjellë ekstraktin familjar ose kontratën e banimit me qiradhënësin se bashku me dëshminë e lëshuar nga Agjencioni për Regjistrim Civil të komunës përkatëse për adresën e re të qiramarrësit, Dëshmi tjera eventuale, të kërkuara nga zyrtari përgjegjës i zyrës pensionale përkatëse.

Kërkesa, së bashku me dokumentet e tjera të përcaktuara në nenin 6 të këtij Udhëzimi, dorëzohet në zyrat e pensioneve përkatëse sipas vendbanimit më të afërt të palës. Zyra e pensioneve, përkatësisht zyrtari përgjegjës i pranimit, sigurohet se kërkesa e paraqitur nga pala ose i/e autorizuari i tij/saj, është e kompletuar sipas nenit 6 të këtij Udhëzimi. Në qoftë se zyrtari përgjegjës konstaton se parashtruesi i kërkesës, nuk e ka plotësuar kërkesën siç parashihet në ligjin në fuqi dhe dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ, zyrtari përgjegjës nxjerr konkluzion mbi plotësimin e lëndës, përkatësisht sigurimin e provave apo dëshmive, kërkon nga parashtruesi që në afat prej 15 ditëve t'i sjellë dëshmitë e kërkuara, me qëllim që kërkesa e tij të përcillet në procedurat e mëtutjeshme për vendimmarrje. Nëse parashtruesi i kërkesës, edhe pas 15 ditëve nuk sjell dëshmi apo provat e kërkuara, atëherë, kërkesa e tij për njohjen e së drejtës në pension invalidor të punës, përmes konkluzionit, i refuzohet kërkesa.

Ndaj refuzimit të kërkesës për aplikim në pension invalidor të punës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë në ankesë në shkallën e dytë të Ministrisë. Në qoftë se zyrtari përgjegjës i pranimit i zyrës pensionale përkatëse, e pranon dokumentacionin si të kompletuar, është i detyruar t'ia lëshojë parashtruesit të kërkesës, dëshminë për pranimin e kërkesës. Kërkesa regjistrohet në librin zyrtar

⁶ udhëzim administrativ (mpms) nr.06/2015 për procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë së përhershme

- në protokoll. Kërkesat për pensionin invalidor të punës, shqyrtohen dhe vlerësohen nga zyrat pensionale përkatëse të Departamentit të Pensioneve të Ministrisë. Në rast se kërkesa është paraqitur sipas nenit 4 paragrafit 2 të këtij Udhëzimi, kërkesa shqyrtohet nga Komisioni Mjekësor i Departamentit të Pensioneve, për shqyrtim dhe vlerësim mjekësor. Komisioni Mjekësor, sipas dëshmive të çertifikuara dhe të konstatuara në bazë të fletëlëndimit në punë dhe ekspertizës për sëmundje profesionale të Autoritetit Përkatës të licencuara për Mjekësi të Punës, në pajtim me legjislacionin në fuqi, e përcakton shkallën e aftësisë të mbetur për punë të shkaktuara gjatë veprimtarisë së punës.

Komisioni Mjekësor, varësisht prej shkallës së aftësisë së mbetur për punë, vendos për njohjen apo mosnjohjen e të drejtës në pension invalidor sipas paaftësisë të plotë për punë si pasojë e lëndimit në punë apo sëmundjes profesionale. Komisioni Mjekësor, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës, lëndën së bashku me dokumentet përcjellëse, e kthen tek organi i shkallës së parë për marrjen e vendimit. Parashtruesi i kërkesës, duhet të njoftohet me shkrim me vendimin e organit kompetent. Të gjitha kërkesat, duhet të shqyrtohet dhe vendoset në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës. Personi i cili ka fituar të drejtën në pension invalidor të punës sipas nenit 9 të këtij Udhëzimi Administrativ dhe është nën moshën 55 vjeqare, i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor pas skadimit të afatit të përcaktuar nga Komisioni Mjekësor, prej një(1), tre (3) apo pesë (5) vitësh. Personi i cili aplikon për herë të parë në realizimin e të drejtës në pension invalidor të punës dhe i njihet kjo e drejtë sipas nenit 9 të këtij Udhëzimi Administrativ, është mbi moshën 55 vjeqare, nuk i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor. Zyrtari përgjegjës i zyrës pensionale përkatëse, 15 ditë para skadimit të vendimit, e njohton shfrytëzuesin e pensionit nga paragrafi 1 i këtij neni, për datën dhe vendin e procedurës së rivlerësimit mjekësor.

Parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me vendimin e shkallës së parë, ka të drejtë të ushtrojë ankesë në komisionin e shkallës së dytë të Ministrisë, përkatësisht në Divizionin për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Parashtrësive dhe Ankesave të Departamentit Ligjor. Ankesa bëhet në formë të shkruar në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Organi i shkallës së dytë, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, nxjerr vendim për miratimin ose refuzimin e ankesës.⁷

4. Procedimi dhe kalkulimi i pagesave

Neni 11 i UA përcakton Procedura e pagesave të pensionit Vendimi mbi njohjen e të drejtës në pension të përcaktuar sipas ligjit në fuqi për skemat pensionale të financuara nga shteti, përmban edhe shumën dhe datën e pagesës. Pagesat e tilla, bëhen nga data e aplikimit, përkatësisht muaji. Zyrtari përgjegjës, i dërgon shfrytëzuesit të pensionit një kopje të vendimit mbi njoftimin për pagesën. Përllogaritja mujore e pagesave për të gjitha skemat pensionale bëhet përmes Sistemit të

⁷ udhëzim administrativ (mpms) nr. 02 12017 për procedurat administrative për njohjen e të drejtës për pension invalidor të punës.

Integruar Informativ. Zyrtari përgjegjës bën përcjelljen e dosjeve tek udhëheqësi i skemave pensionale për veprim të mëtutjeshëm.

Të gjitha pensionet që paguhen sipas këtij ligji, do të fillojnë të paguhen nga dita e parashtrimit të kërkesës. Pagesat bëhen vetëm në konton bankare të pensionistit, e cila është verifikuar nga Ministria gjatë shqyrtimit të kërkesës për pension. Neni 21 Ndërprerja e pagesës së pensioneve Pagesat e pensionit bazik të moshës dhe i aftësisë së kufizuar të përcaktuara me këtë ligj, do të ndërpriten, si në rastet e mëposhtme: 1.1. në rast të vdekjes së pensionistit, pagesa e pensionit ndërpritet në muajin pasues pas vdekjes së tij/saj; 1.2. në rast se përfituesi i pensionit bazik të moshës dhe i aftësisë së kufizuar, fiton nënshitetësinë e shtetit, me të cilin Republika e Kosovës, nuk ka Marrëveshje Bilaterale për sigurime sociale; 1.3. nëse vlerësohet së parashtruesi i kërkesës ka bërë mashtrim apo keqinterpretim gjatë procesit të aplikimit ose gjatë monitorimit dhe inspektimit nga zyrtarët përgjegjës të Ministrisë, konstatohen prova materiale të rrejshme nga ana e pensionistit. 2. Pagesa e pensioneve për shfrytëzuesit e pensioneve kontributpaguese të përcaktuara me këtë Ligj, do të ndërpriten, si në rastet e mëposhtme: 2.1. në rast të vdekjes së pensionistit, pagesa e pensionit ndërpritet në muajin pasues pas vdekjes së tij/saj; 2.2. nëse vlerësohet së parashtruesi i kërkesës ka bërë mashtrim apo keqinterpretim gjatë procesit të aplikimit ose gjatë monitorimit dhe inspektimit nga zyrtarët përgjegjës të Ministrisë, konstatohen prova materiale të rrejshme nga ana e pensionistit.

Neni 22 Korrigjimet e pagesave të pensioneve. Kur personi është paguar më pak se shuma e pensionit, Ministria paguan borxhin e mbetur në kohën brenda muajit vijues. Nëse personi ka vdekur, shumat e mbetura borxh ndaj personit para se të vdesë do t'i paguhen bashkëshortit /bashkëshortes së tij/saj, apo nëse ai/ajo nuk ka bashkëshort/e, shuma do t'iu paguhet fëmijëve në pjesë të barabarta, dhe në rast se personi nuk ka as bashkëshort/e as fëmijë, atëherë shuma iu paguhet prindërve të personit apo kujdestarit ligjor. Neni 23 Pagesat e gabuara dhe pagesat e tepërta të pensioneve 1. Secili person që është pranues i ndonjë pagese të pensionit të bërë gabim në konton bankare të tij/saj, apo që iu është paguar ndonjë shumë më tepër sesa që i takon, do të kërkohet që ta kthejë shumën e plotë, pavarësisht arsyes së bërjes së pagesës së gabuar apo të tepërt.

Nëse një person me vetëdije merr një pagesë të gabuar apo një pagesë të tepërt të pensionit, ai ose ajo duhet informojë pa vonesë rreth shumës së pranuar, Ministrinë. Nëse Ministria, identifikon ndonjë pagesë të gabuar apo të tepërt ndaj një pensionisti apo personi tjetër, do të lajmërojë me shkrim personin rreth pagesës. Lajmërimi duhet të përshkruajë shumën e pagesës, datën kur është bërë pagesa e tepërt dhe masat që ndërmerr Ministria për të përmirësuar pagesat e gabuara apo të tepërta. Këto masa mund të jenë: 3.1. zbritja e shumës nga pagesat e ardhshme për të siguruar përmirësimin e gabimit në kohën më të shkurtër të mundshme; kërkesën me shkrim për të kthyer shumën ndaj personit.

Gjatë shqyrtimit të mënyrës dhe shpejtësisë së mbledhjes së pagesave të gabuara, Ministria, mund të marrë parasysh nevojat ekonomike të pensionistit dhe mund të riprogramojë kthimin e pagesave për të reflektuar rrethanat ekonomike. Nëse një person që merr lajmërimin për një pagesë të gabuar ose të tepërt, nuk pajtohet me shumën e paguar që pretendon Ministria, ose me metodën, me të cilën

ajo kërkon të kthehet pagesa, ai ose ajo mund të kërkojë rishqyrtim të procedurës. 6. Nëse pala refuzon të kthejë pagesat e paguara pa bazë ligjore, atëherë Ministria, do iniciojë procedurën gjyqësore në Gjykatën përkatëse. Neni 24 Vdekja e pensionistit 1. Ministria, do të ndër marrë veprime me të cilat do të monitorojë burimet ekzistuese të informatave për të identifikuar pensionistët që kanë vdekur, me qëllim që të bëjë ndërprerjen e pagesës së Pensionit sa më parë që është e mundur. 2. Shfrytëzuesit e pensionit bazik të moshës dhe shfrytëzuesit e pensioneve të parakohshme duhet të paraqiten në zyrat e caktuara nga Ministria një herë në gjashtë muaj me dokumentet përkatëse të identifikimit. 3. Ministria mund të suspendojë përkohësisht pagesën e pensionit nëse pensionisti nuk arrin të bëjë një gjë të tillë konform paragrafit 2 të këtij neni. 4. Suspendimi nga pagesa e pensionistëve në shfrytëzimin e pensioneve, do të përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria.

Verifikimi dhe monitorimi i dëshmive të parashtruesit të kërkesës për pension Ministria do të krijojë një proces inspektimi për monitorimin e pagesave të pensioneve për të siguruar që personat të cilët marrin pension janë të kualifikuar dhe me rastin e inspektimit mund të verifikojë që: 1.1. personi që merr pagesa të tilla është në jetë; 1.2. kontoja bankare në të cilën paguhet pensioni është vërtetë konto e pensionistit të cilit i bëhet pagesa; 1.3. gjendja shëndetësore e personit që merr pension të aftësisë së kufizuar, të jetë në përputhje me diagnozat mjekësore; 1.4. ish-punëtorët e Kompleksit të Minierave të Trepçës dhe minierave të tjera të vendit që përfitojnë pensionin të parakohshëm, nuk mund të jenë të punësuar ose të vetëpunësuar dhe të duhen të jenë mbi pesëdhjetë për qind (50%) me aftësi të kufizuara; dhe, 1.5. çdo verifikim tjetër që Ministria e vlerëson si të arsyeshëm dhe të nevojshëm për të siguruar menaxhimin dhe administrimin e mirëfilltë të pensioneve. 2. Kur vlerësohet se një person, nuk i plotëson kushtet dhe kriteret për pensionet e përcaktuara me këtë ligj, nga ai do të kërkohej që të kthejë shumën e pagesave që i është bërë atij ose asaj. Neni 26 Shfrytëzuesit aktual të pensioneve

Të gjithë shfrytëzuesit aktual të pensioneve bazike të moshës, pensionistëve kontributpagues, të pensioneve të aftësisë së kufizuar, të cilat janë të përcaktuara me aktet ligjore dhe nënligjore të mëhershme, që nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji do të konsiderohen të kualifikuar dhe nga ata nuk do të kërkohej që të aplikojnë për pensionet e përcaktuara me këtë ligj. 2. Përfshirësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, shfrytëzuesit aktual të pensioneve të parakohshme, duhet të aplikojnë, sipas dispozitave të këtij ligji, nga data e hyrjes në fuqi. Zyrtari i Divizionit të Skemave Pensionale i ngarkuar për përgatitjen dhe caktimin e listës së pagesave, nxjerr raportin e listave nga baza e shënimeve. Në Sistemin e Integruar Informativ, ruhet versioni elektronik i pagesave të shfrytëzuesve, raportet e përgjithshme dhe raportet e ndara sipas bankave përkatëse. Lista e pagesave të secilit përfitues, përfshin këto informata:

- 2.1. Numri i bankës;
- 2.2. Numri rendor;
- 2.3. Tipi i Pagesës;
- 2.4. Përshkrimi i Pagesës;
- 2.5. Numri rendor i pensionistit;

- 2.6. Shuma për pagesë;
- 2.7. Llogaria e institucionit dërgues;
- 2.8. Institucioni dërgues;
- 2.9. Llogaria e bankës pranuese;
- 2.10. Emri dhe Mbiemri i pensionistit;
- 2.11. Llogaria e pensionistit;
- 3.12. Muaji dhe viti i pagesës;
- 3.13. Data e pagesës dhe
- 3.14. Id- e pensionistit.

Dispozitat e nenit 6 i këtij Udhëzimi Administrativ, do të zbatohet në përputhje me fondet buxhetore në dispozicion.⁸

⁸ Udhëzim Administrativ (mpms) nr.07/2015 për procedurat e aplikimit dhe ankimit në skema pensionale të financuara nga shteti.